



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.01.2024

Nr: 07

Ora: 13:30

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 01, DATË 08.01.2024 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 16.01.2024, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ referuar vendimit nr. 824, datë 07.12.2023 "Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 19 pika 1 shkronja "c" dhe 21 pika 1 shkronja "dh" të Kodit Zgjedhor.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar raportin e gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjeshme vendore, të datës 6 Mars 2022 dhe me vendimin e tij nr. 824, datë 07.12.2023, pasuar nga kërkesa nr. 01, datë 08.01.2024, ndër të tjera i ka kërkuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) vendosjen e sanksionit administrativ me gjobë, për shkelje të dispozitave të nenit 173, të Kodit Zgjedhor dhe sipas nenit 23/4, pika 3 të ligjit “Për Partitë Politike” për një numër subjektsh zgjedhore, si vijon:

- Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”, me gjobë në vlerën 3 000 000 (tre milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 3 të ligjit “Për Partitë Politike”;
- Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokratike”, me gjobë në vlerën 3 000 000 (tre milion) lekë, sipas nenit 23/4, pika 3 të ligjit “Për Partitë Politike”;
- Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokratike”, me gjobë në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor.;
- Marrjen e masës administrative, për partinë politike “Partia Demokratike”, me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas nenit 173, pika 8 të Kodit Zgjedhor;
- Marrjen e masës administrative, për kandidaten për kryetare bashkie të Partisë Socialiste e Shqipërisë, zj. Emirjana Sako, me gjobë në vlerën 92.775 lekë dhe dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor;
- Marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Partisë Socialiste e Shqipërisë, z. Edison Memolla, me gjobë në vlerën 120.590 lekë dhe dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor;
- Marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Koalicionit Shtëpia e Lirisë, z. Bardh Spahia, me gjobë në vlerën 91.420 lekë dhe dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor;

- Marrjen e masës administrative, për kandidatin për kryetar bashkie të Koalicionit Shtëpia e Lirisë, z. Ardian Muka, me gjobë në vlerën 415.000 lekë dhe dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së sipas nenit 173, pika 5 të Kodit Zgjedhor;
2. KAS-i vendosi që relator për shqyrtimin e kësaj çështje të jëtë z. Elvis Çefa, sipas shortit të hedhur më datë 10.01.2024.
 3. Më datë 12.01.2024, u zhvillua seanca paraprake për Kërkesën nr. 01, datë 08.01.2024 të KSHZ, ku në përfundim KAS vendosi pranimin për shqyrtim të kësaj kërkesë.
 4. Në seancën e datës 16.01.2024, KAS-i mori në shqyrtim kërkesën e Komisionerit, të prezantuar nga z. Ylli Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së, në prani të përfaqësuesve të palëve të interesuara:
 - Partia Demokratike e Shqipërsë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa;
 - Partia Solialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi
 - Ardian Muka, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. Franci Nuri;
 - Emiriana Sako, përfaqësuar nga z. Alvaro Kaçupi dhe z. Ermal Lufo;
 - Edison Memolla, përfaqësuar nga zj Erinda Memolla.
 5. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së kërkoi miratimin e kërkesës së Komisionerit, ndërsa përfaqësuesit e pranishëm të palëve të interesuara kërkuan rrëzimin e saj.
 6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesën e nr. 01, datë 08.01.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 - Vendimin nr. 824, datë 07.12.2023 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022”, të KSHZ nr.224, datë 07.12.2022;
 - Raporti i gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstaton:

1. Persa i përket propozimit lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 23/4 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar, KAS vëren se:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në kërkesën e tij nr. 1 drejtuar KAS, mosdeklarimin e saktë nga ana e subjekteve zgjedhore “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe “Partia Demokratike e Shqipërisë” të zyrave elektorale si edhe të shpenzimeve për mediat sociale të kandidatëve të tyre për kryetarë bashkie në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, i ka konsideruar si “Refuzim për të bërë transparent burimet e financimit të partisë politike apo për të lejuar ushtrimin e kontrollit nga ana e ekspertit kontabël të licencuara të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” në kuptim të nenit 23/4 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar. Për rrjedhojë, bazuar pikërisht në këtë dispozitë, KSHZ ka propozuar edhe sanksionin përkatës kundrejt dy partive politike në fjalë.

KAS, në analizë tërësore të dispozitave të ligjit të mësipërm të referuara nga ana e KSHZ, vlerëson se neni 23/4 është pjesë e kreut III “Mjetet financiare dhe materiale të partive” të ligjit “Për partitë politike”, i ndryshuar. Ky kre rregullon aktivitetin financiar të partive politike gjatë periudhës së zakonshme (të përditshme) jozgjedhore të ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Në këtë ligj, rregullimi i mjeteve financiare dhe aktivitetit financiar të partive është bërë në kreun III/1 të tij (nenet 24/1 deri në 24/5). Ky kre është shfuqizuar tërësisht nga ligji nr. 135/2020, datë 16.11.2020 pas rregullimit që i bëri ligjvënësi në Kodin Zgjedhor dhe konkretisht në kreun I, të pjesës VII të tij me titull “Financimi i zgjedhjeve”.

Gjatë shqyrtimit në seancë publike në datën 16.1.2024, pasi dëgjoi edhe argumentet dhe pretendimet e palëve të interesuara, KAS vlerëson se shkeljet e referuara në pikën 1 dhe në pjesën e parë, të pikës 2, të kërkesës nr. 1 të KSHZ, qëndrojnë në pjesën më të madhe të tyre, pavarësisht hetimit jo të plotë dhe të thelluar të bërë nga administrata e KQZ. KAS vlerëson se parregullsitë në deklarimin e bërë nga dy subjektet politike përsa i përket

fushatës së zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022 në tërësinë e tyre qëndrojnë.

Gjatë hetimit administrativ u provua fakti se shkeljet ligjore të mësipërme, janë kryer gjatë periudhës zgjedhore dhe pikërisht në funksion të zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 Mars 2022 dhe kanë të bëjnë në mënyrë konkrete me financimin e zgjedhjeve dhe të fushatës në kuptim të kreut I “Financimi I zgjedhjeve” të pjesës VII, të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, KAS arrin në përfundimin se ligji i zbatueshëm për efekt të rregullimit të deklarimit të shpenzimeve të kryera për fushatën zgjedhore dhe më tej për efekt të sanksionimit të parregullsive të konstatuara në kryerjen e këtyre shpenzimeve në këtë rast, është Kodi Zgjedhor dhe jo ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.

KAS vlerëson se sanksionet ndaj këtyre shkeljeve duhet të vendosen duke u referuar në pikën 1, të neni 173 të Kodit Zgjedhor. Në rastin konkret nuk mund të zbatohen sanksionet e parashikuara nga pika 2, e nenit 173 të Kodit Zgjedhor, pasi kjo dispozitë, në mënyrë që të sanksionohet subjekti zgjedhor për këto lloj parregullsish, kërkon detyrimisht që të vërtetohet “pengimi” ose “mosbashkëpunimi” i subjektit zgjedhor me audituesin e caktuar nga KQZ. Nga vetë përmbajtja e kërkesës së KSHZ, por edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë, nuk rezultoi se në rastin konkret të jetë konstatuar ndonjë pengim apo mosbashkëpunim i subjekteve politike në fjalë ndaj/me audituesit e caktuar nga KQZ.

Administrata e KQZ nuk ngriti asnjë pretendim dhe nuk paraqiti asnjë provë në lidhje me faktin se subjektet zgjedhor në fjalë të kenë penguar me veprime apo mosveprime konkrete audituesit në punën e tyre. Madje në seancë, nga përfaqësuesit e KQZ u deklarua se audituesit e caktuar nga ana e KQZ deri në atë moment, ende nuk e kanë përfunduar dhe për rrjedhojë nuk e kanë dorëzuar aktin e auditimit të fondeve të shpenzuara në fushatë nga subjektet zgjedhore.

Në këtë kontekst KAS vlerëson se shkeljet e parashtruara në pikën 1 dhe në pjesën e parë të pikës 2, të kërkesës nr. 1 të KSHZ, të cilat konsistojnë në deklarime të pasakta të numrit të zyrave elektorale dhe të shpenzimeve të bëra nëpërmjet rrjeteve sociale për kandidatët e këtyre partive, ngarkojnë me përgjegjësi përkatësisht personat përgjegjës të financës të

partive politike respektive dhe për rrjedhojë, referuar pikës 1, të nenit 173 të Kodit Zgjedhor, janë këta personat të cilët duhet të sanksionohen me gjobë.

2. Përsa i përket propozimit lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 173, pika 3 dhe pika 8 të Kodit Zgjedhor, nga ana e Partisë Demokratike, KAS vëren se:

KAS i vlerëson të drejta dhe të bazuara konstatimet e parashtruara në pjesën e dytë, të pikës 2, të kërkesës nr. 1 të KSHZ, lidhur me dorëzimin nga Partia Demokratike e raportit financiar për fushatën zgjedhore jashtë afatit dhe në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ. Mosdorëzimin e këtij raporti për 5 (pesë) kandidatë për kryetar bashkie nga ana e Partisë Demokratike, e bën atë jo të plotë, çka është një veprim që bie në kundërshtim edhe me parashikimet e vendimit nr. 9, datë 29.1.2022, të Komisionit Rregullator në KQZ. Ky fakt u pranua edhe nga vetë përfaqësuesi i këtij subjekti në seancën e datës 16.1.2024.

KAS vlerëson se qëndrojnë pjesërisht argumentet e paraqitura nga përfaqësuesi i kësaj partie në seancën e datës 16.1.2024, për pamundësi objektive në kthimin e përgjigjes ndaj kërkesës me shkrim drejtuar kësaj partie nga vetë KQZ, apo në dorëzimin në kohë të raportit financiar për fushatën zgjedhore, për shkak të pasojave të ardhura nga situata specifike dhe jonormale që ndodhi në atë periudhë brenda vetë kësaj partie, fakt i cili është i njohur botërisht.

Po ashtu, në interpretim të pikës 8, të nenit 173 të Kodit Zgjedhor, mungesa e bashkëpunimit duhet të materializohet në veprime konkrete që shprehin një vullnet të qartë për të refuzuar bashkëpunimin, në asgjësimin e dokumenteve apo në sjellje të papërshtatshme të qëllimshme gjatë procesit e verifikimit të kryer nga KQZ. Në këtë kontekst, konsiderohet i paprovuar pretendimi i parashtruar në pjesën e tretë, të pikës 2, të kërkesës nr. 1 të KSHZ, se Partia Demokratike ka refuzuar të bashkëpunojë me KQZ.

KAS konstaton se zgjatja nga administrata e KQZ prej më shumë se një vit e hetimit administrativ për verifikimin e rasteve të referuara në kërkesën objekt shqyrtimi, përveçse

cënon parimin e sigurisë juridike, zbeh në vetvete edhe efektin që duhet të japin sanksionet administrative ndaj subjekteve që kanë kryer veprime në shkelje të dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor, duke cënuar në thelb edhe përmbushjen e qëllimit edukues që kanë këto dispozita.

Duhet marrë në konsideratë fakti se subjekti gjithsesi e ka paraqitur raportimin financiar, me një vonesë jo më të gjatë se 2 javë.

Në vlerësim të të gjitha këtyre rrethanave, KAS vlerëson se duhet pranuar arsyetimi justifikues i subjektit, duke mos e sanksionuar atë për refuzim apo mosbashkëpunim. Gjithsesi detyrimi për rregullshmërinë e raportimit mbetet. Ky prezumohet i ditur dhe duhet të jetë një proces “rutinë” për një subjekt zgjedhor. Për këtë arsye, KAS vlerëson se në këtë rast sanksioni ndaj këtij subjekti politik nuk duhet të aplikohet në maksimumin e parashikuar në nenin 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

3. Përsa i përket propozimeve lidhur me shkeljet ligjore të parashtruara në pikën 3 të kërkesës nr. 1 të KSHZ, KAS vëren se:

KQZ, duke marrë si indicie denoncimin e bërë nga organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka shqyrtuar raportet e auditimit të dorëzuara nga subjektet zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022. Pas shqyrtimit të raporteve KQZ ka konkluduar se:

Zj. Emirjana Sako, në raportin e saj si kandidate e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste” i ka dhuruar vetes 92.775 lekë kesh.

Z. Edison Memolla, në raportin tij si kandidat i subjektit zgjedhor i Partisë Socialiste i ka dhuruar vetes 120.590 lekë kesh.

Z. Ardian Muka, në raportin e tij si kandidat i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, i ka dhuruar vetes shumë 415.000 lekë kesh (të ndarë në tre kështe dhuruar në 120.000 lekë, 150.000 lekë dhe 145.000 lekë).

Z. Bardh Spahia, në raportin e tij si kandidat i Koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, i ka dhuruar vetes 91.420 lekë kesh (të ndarë në dy kështe 40.000 lekë dhe 51.420 lekë).

Si fillim, KAS konstaton se termi “*i ka dhuruar vetes*” i përdorur nga KSHZ në kërkesën nr. 1 drejtuar KAS, nënkupton “*financimin nga burime vetjake të vetë kandidatëve*”, në kuptim të vendimit nr. 13, datë 4.2.2022, të Komisionit Rregullator “Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetarë për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore”. Ky term është përdorur nga KSHZ në referim të deklaramëve të vetë subjekteve të bëra në raportet e auditimit të dorëzuara nga subjektet zgjedhore.

KAS në seancën e datës 16.1.2024 dëgjoi pretendimet e përfaqësuesve të 3 kandidatëve Emirjana Sako, Edison Memolla dhe Ardian Muka, ndërkohë që kandidati Bardh Spahia nuk u paraqit në seancë, megjithëse rezultoi të jetë njoftuar rregullisht konform ligjit. Pasi dëgjoi pretendimet e palëve të interesuara KAS konstaton se:

Përfaqësuesi i Zj. **Emirjana Sako** parashtroi se kandidatja në fjalë është vetë personi që ka financuar fushatën e saj dhe shpenzimet totale për fushatën kanë qenë në shumën 92.775 lekë, të cilat janë të ndara në 8 fatura të paraqitura dhe të administruara në cilësinë e provës nga KAS. Përfaqësuesi në fjalë nuk dha ndonjë argument të qartë lidhur me faktin nëse këto fonde të vetëfinancuara nga zj. Sako për fushatën e saj, janë derdhur në llogarinë bankare të posaçme sipas urdhërimeve të Kodit Zgjedhor.

KAS pasi i shqyrtoi të gjitha provat e paraqitura, konstaton se në formularët e raportimit financiar të shpenzimeve të depozituar në KQZ nga vetë kandidatja Sako, rezultoi se në tabelën “3. shpenzime”, janë deklaruar shpenzimet e pasqyruara në faturat e sipërcituara. Në kolonën “Metoda e kryerjes së pagesës” të po kësaj tabele, përbri këtyre shumave respektive rezultoi shënimi “Para në dorë/cash”.

Në këtë kontekst, KAS vlerëson se kandidatja Sako nuk arriti të provojë me asnjë dokument shkresor faktin se shpenzimet e fushatës në shumën 92.775 lekë të financuara nga burime vetjake, ajo t’i ketë kaluar nëpërmjet llogarisë bankare të posaçme sikurse sanksionon Kodi Zgjedhor. Për këtë arsye, KAS në referim të pasqyrave të raportimit financiar të dorëzuar në KQZ nga vetë kandidatja, arrin në përfundimin se ajo ka kryer shkelje të parashikimeve të sanksionuara në nenin 92/2 pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor si dhe në vendimin nr. 13, datë

4.2.2022, të Komisionit Rregullator “Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetarë për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore”.

Përfaqësuesi i Z. **Edison Memolla** parashtrori në seancë se z. Memolla ka financuar fushatën e tij nga burime vetiake vetëm në shumën 9.590 lekë, shumë e cila është nën limitin e kërkuar nga ligji, ndërsa pjesa tjetër e fondeve të shpenzuara në fushatë kanë ardhur nga dhurues të tjerë privatë dhurime të cilat janë bërë kurdoherë nëpërmjet llogarisë bankare të posaçme. Në cilësinë e provës u paraqit:

- Pasqyra e lëvizjeve në llogarinë bankare të Posaçme lëshuar nga OTP Bank, dokument i cili u administrua në cilësinë e provës.
- Pasqyra e nxjerrjes së llogarisë,
- Raportin financiar të dorëzuar në KQZ nga vetë kandidati.

Nga vlerësimi i bërë nga KAS i raportit financiar të dorëzuar nga vetë kandidati rezulton se në *“Tabelën 2.a Të ardhura monetare – Financime jopublike”* janë deklaruar dhurimet monetare për kandidatin, ku rezulton se në datën 14.2.2022 Edison Memolla ka dhuruar 120.590,62 lekë. Në kolonën *“Metoda e kryerjes së pagesës”* të po kësaj table përbri këtyre shumave respektive rezulton shënimi *“Para në dorë/cash”*.

Lidhur me këtë konstatim, përfaqësuesi i z. Memolla i pyetur në seancë nuk arriti të jepte shpjegime të qarta lidhur me veprimet e kryera për këtë shumë të hollash, por pranoi faktin se kjo shumë është shpenzuar në kesh nga ana e kandidatit.

Në këto rrethana, KAS vlerëson se kandidati Memolla nuk arriti të provojë me asnjë dokument shkresor faktin se shpenzimi i kryer për fushatën e tij zgjedhore në shumën 120.590,62 lekë të financuara nga burime vetjake, ai t’i ketë kaluar nëpërmjet llogarisë bankare të posaçme, sikurse sanksionon Kodi Zgjedhor. Për këtë arsye, KAS arrin në përfundimin se ai ka kryer shkelje të parashikimeve të sanksionuara në nenin 92/2, pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor si dhe në vendimin nr. 13, datë 4.2.2022, të Komisionit Rregullator “Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetarë për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore”.

Përfaqësuesi i Z. **Ardian Muka** parashtroi se, kandidati në fjalë ka depozituar në llogarinë e posaçme, në formën e financimit nga burime vetjake, shumën totale prej 900.000 lekë të cilën e ka tërhequr nga llogaria bankare private. Sipas tij, 3 shumat e pretenduara në Kërkesën nr. 1 të KSHZ janë në fakt 3 blerje të kryera me para në dorë kundrejt të tretëve nga vetë kandidati dhe nuk janë “*dhurime ndaj vetes*” sikurse pretendohet nga KSHZ. Për të provuar këtë fakt, përfaqësuesi i z. Muka paraqiti kopje të 3 faturave tatimore, të cilat u administruan si provë, përkatësisht:

- Faturë e datës 1.3.2022 në shumën 120.000 lekë për fletëpalosje;
- Faturë e datës 4.3.2022 në shumën 150.000 lekë për marrje karrige me qira;
- Fatura e datës 10.3.2022 në shumën 145.000 lekë për printime;
- Pasqyrë e veprimeve në llogarinë speciale të Intesa Sanpaolo Bank; dhe
- Formularët e raportimit financiar të shpenzimeve të fushatës të depozituara në KQZ për këtë kandidat.

KAS pasi i shqyrtoi të gjitha provat e paraqitura, konstaton se në formularët e raportimit financiar të shpenzimeve të depozituar në KQZ nga vetë kandidati Muka, rezulton se në tabelën “*2.a Të ardhura monetare – Financime jopublike*”, ndër të tjera janë deklaruar si dhurim nga Ardian Muka shuma 120.000 lekë të datës 1.3.2022, shuma 150.000 lekë në datën 4.3.2022 dhe shuma 145.000 lekë në datën 10.3.2022. Në kolonën “*Metoda e dhurimit*” të po kësaj tablele, përbri këtyre shumave respektive rezulton shënimi “*Para në dorë/cash*”. Është lehtësisht i dallueshëm fakti se shumat dhe datat përputhen tërësisht me shumat dhe datat e tre blerjeve të kryera nga kandidati me para në dorë. Deklarimi i këtyre shumave si dhurim, në tabelën e mësipërme, mund të shpjegohet si gabim apo lajthitje e personit që ka plotësuar të dhënat në tabelë.

Po ashtu nga kqyrja e pasqyrës së veprimeve në llogarinë e posaçme të Intesa Sanpaolo Bank, rezulton se përputhen deklaratimet e bëra në seancë nga vetë kandidati. Ai ka depozituar në këtë llogari në formën e vetëfinancimit shumën prej 900.000 lekë në datën 01.3.2022, shumën 7.000 lekë në datë 28.4.2022 dhe shumën 43 000 lekë në datën 11.5.2022. Po ashtu shumat në Lekë që i përkasin derdhjeve dhe shpenzimeve të kryera nëpërmjet kësaj llogarie bankare të posaçme përputhen me deklaratimet e kandidatit Muka në raportin financiar të shpenzimeve.

Në këtë kontekst, KAS vlerëson se kandidati Muka nuk ka kryer pranim të fondeve private me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare (pra me para në dorë). Në këtë kontekst ky kandidat nuk ka kryer as shkelje të parashikimeve të sanksionuara në nenin 92/2, pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor si dhe në vendimin nr. 13, datë 4.2.2022, të Komisionit Rregullator “Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetarë për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore”.

Përsa i përket kandidatit z. **Bardh Spahia**, duke qenë se ai nuk tregoi interes për t’u paraqitur në këtë procedim administrativ për të kundërshtuar gjetjet nga ana e KSHZ dhe për të dhënë shpjegimet e tij, në vlerësimin e propozimit për sanksionim të këtij kandidati, KAS do ti referohet pasqyrave të raportimit financiar të dorëzuar në KQZ nga vetë kandidati.

Nga kqyrja dhe vlerësimi i bërë nga KAS i raportit financiar të dorëzuar nga vetë kandidati rezulton se në *“Taben 2.a Të ardhura monetare – Financime jopublike”* janë deklaruar dhurimet monetare për kandidatin ku rezulton se në datën 10.5.2022 dhe në datën 11.5.2022, Bardh Spahia ka dhuruar përkatësisht shumën 40.000 lekë dhe 51.420 lekë. Në kolonën *“Metoda e kryerjes së pagesës”* të po kësaj tablele përbri këtyre shumave respektive rezulton shënimi *“Para në dorë/cash”*.

Pas vlerësimit të këtij dokumentacioni, KAS arrin në përfundimin se kandidati Bardh Spahia duke financuar fushatën e tij nga burime vetiake pa i kaluar ato nëpërmjet llogarisë bankare të posaçme sikurse sanksionon Kodi Zgjedhor, ka kryer shkelje të parashikimeve të sanksionuara në nenin 92/2, pikat 2 dhe 3 të Kodit Zgjedhor si dhe në vendimin nr. 13, datë 4.2.2022 të Komisionit Rregullator “Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetarë për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore”.

Në lidhje me të drejtën e ankimit, duke qenë se subjektet e sanksionuar janë dënuar administrativisht në cilësinë e subjektit zgjedhor, në zbatim të nenit 145, pika 1 të K.Zgjedhor që parashikon se *“Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi”*, ata mund ta ushtrojnë të

drejtën e ankimit pikërisht duke ju drejtuar Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Duke qenë se ky vendim është marrë jashtë periudhës e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit për zgjedhje, atëherë ankimi bëhet brenda 30 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 01, datë 08.01.2024 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në vlerën 100 000 Lek ndaj personit përgjegjës për financat në Partinë Socialiste të Shqipërisë, bazuar në pikën 1 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
3. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në vlerën 100 000 Lek ndaj personit përgjegjës për financat në Partinë Demokratike të Shqipërisë, bazuar në pikën 1 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
4. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në vlerën 750 000 Lek ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë, bazuar në pikën 3 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
5. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në vlerën 92.775 lekë ndaj zj. Emirjana Sako, kandidate për kryetare bashkie e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, bazuar në pikën 5 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.
6. Vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në vlerën 120.590 Lek ndaj z. Edison Memolla, kandidat për kryetare bashkie i "Partisë Socialiste të Shqipërisë", dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, bazuar në pikën 5 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.

7. Vendosi e sanksionit administrativ gjobë në vlerën 91.420 Lek ndaj z. Bardh Spahia, kandidat për kryetar bashkie i koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, dhe kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së, bazuar në pikën 5 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

U shpall në Tiranë, sot me datë 19.1.2024.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar